

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

PKR.nr.279/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare, anëtarëve të trupit gjykues - gjyqtarët Beqir Kalludra dhe Shashivar Hoti, me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.P.për shkak të veprës penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për krime të rënda PP/I.nr.308/2015, të dt: 12.05.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e publik, në prezencën prokurorës të shtetit Besa Limani, të akuzuarit A.P.dhe mbrojtësit av.N.R. sipas detyrës zyrtare, me dt.28.09.2018 mori dhe publikisht shpallë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

A.P., nga i ati M., e ëma E., e gjinisë D., i lindur me dt. ..., në fshatin “L.”, Komuna e O.1 me vendbanim në O.2, në rrugën “... M.”, i papunë, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjës së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 364 par.1 nënpar 1.3 të KPPK,

LIROHET NGA AKUZA

SEPSE: me datë 29.04.2015 rreth orës 15:45 minuta në O.2 në afërsi të shkollës së mesme, pas një mosmarëveshje që kishte pasur me fqinun e tij, të dëmtuarin N.T. i cili kishte qenë duke u shëtitur rrugës me qenin e tij dhe në momentin që ishte afruar afër shtëpisë së të pandehurit, qeni i të dëmtuarit N.T. me qenin e të pandehurit të lartëcekur ishin kacafytur, ashtu që në atë moment i pandehuri

A.P.ka hy në shtëpinë e tij, e ka marr pushkën e gjuetisë model turk e kalibrit 12 mm me numër serik 171442, ka dalur jashtë dhe me qëllim frikësimi i'a ka drejtuar pushkën të dëmtuarit N.T., e që pushka e gjuetisë e lartëcekur me dy fishek i është gjetur të pandehurit të lartëcekur dhe i është konfiskuar nga ana e policisë,-

- Me çka kishte për të kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK-së.

Arma e tipit “Bokerië”, e modelit Turk me kalibër 12 mm, me nr. Serik 171442, nuk konfiskohet, mirëpo e njëjta nuk i kthehet te akuzuari deri sa i njëjti të pajiset me leje te armës, gjegjësisht Arma do te konfiskohet me aktvendim te vecante nëse i akuzuari brenda afatit prej 60 ditë nga shpallaj e aktgjykimit, nuk i vazhdot leja e armës, nga organi kompetent.

Shpenzimet e procedurës penale, mbesin barrë e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.308/2015, të dt: 12.05.2015, kundër të akuzuarit A.P.për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPK-së.

Gjykata, ka caktuar shqyrtimin gjyqësor dhe pas leximit të aktakuzës, me rastin e deklarimit të të akuzuarit lidhur me çështjen e fajësisë në kuptim të nenit 326 parg 1 të KPPRK-së, i akuzuari ka deklaruar se nuk e pranon fajsinë, dhe duke qenë se i akuzuari nuk e ka pranuar fajsinë për veprën penale sipas aktakuzës, gjykata duke u bazuar në nenin 327 parg 1 nënparag 1.2 të KPPRK-së, ka vendosë zhvillimin e shqyrtimin gjyqësor me prezentimin dhe administrimin e provave.

Prokurorja Besa Limani në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka deklaruar se nga dëshmitë e dëshmitarit/të dëmtuarit N.T. të dhëna në procedurën paraprake dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe nga provat materiale sic janë lista e armëve të konfiskuara, formulari i konfiskimit dhe vërtetimi mbi bastisjen e shtëpisë të datë 29.04.2015 është vërtetuar gjendja faktike se tani i akuzuari A.P.ka kryer veprën penale që i vihet barrë ashtu sic është përshkruar në dispozitiv të aktakuzes, ashtu që I njëjti me datë 29.04.2015, pas një mosmarrëveshje që kishte pasur me tani të dëmtuarin N.T. në rrugë pranë shtëpisë së tani të akuzuarit, për shkak të kacafytjës në mes të qenit të dëmtuarit I cili kishte qenë I lidhur dhe qenit të tij, kishte hyrë brenda dhe kishte marrur pushkën e gjuetisë, të cilën i'a kishte drejtuar tani të dëmtuarit N.T., i cili pastaj kishte njoftuar policinë. Andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.P., av. N.R., në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka deklaruar se aktakuza e ngritur kundër të mbrojturit të tij nuk është e mbështetur në prova të mjaftueshme e të bazuara të cilat do ta argumentonin faktin se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale me të cilën është ngarkuar, dhe atë nisur nga deklarata e tani të

dëshmitarit/dëmtuarit N.T. e dhënë në seancën gjyqësore e cila ka qenë kundërthënëse dhe në jo përputhshmëri me atë që kishte deklaruar në procedurë paraprake, e në shumë raste duke rënë në kundërshtim me veten e duke u arsyetuar me faktin se ka harruar se si ka rrjedhur ngjarja. Më tutje ka shtuar se sipas raportit të dt: 29.04.2015 i përpiluar nga zyrtarja e policisë K.H. i njëjti në ditën kur kishte shkuar për të lajmëruar rastin në stacionin policor ka qenë në gjendje të dehur, nën substanca narkotike dhe shumë agresiv, fakt ky që e bënë edhe më të pabesueshëm deklaratën e këtij dëshmitari/të dëmtuari. Po ashtu I njëjti nuk ka arritur të shpjegojë qarte nëse tani I akuzuari e ka përdorur armën në ditën kritike, duke ndryshuar kështu deklaratimet e tij me pretendimin se nuk i kujtohet. Andaj, duke pasur parasysh këtë që u tha më lartë, i ka propozuar gjykatës që i mbrojturi i tij A.P.të shpallet i pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari A.P., në tërësi e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit, duke shtuar se vetën e konsideron të pafajshëm dhe kërkon që gjykata t'a lirojë nga aktakuza.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka proceduar dhe administruar të gjitha provat personale dhe materiale të propozuara nga palët në procedurë, sic janë dëshmim e dëshmitarit/dëmtuarit N.T., listën e armëve të konfiskuara të datë 29.04.2015, formularin e konfiskimit të datë 29.04.2015, vërtetimin mbi bastisjen e shtëpisë të datë 29.04.2015, raportin e zyrtarës policore K.H. të datë 29.04.2015 si dhe foto-dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës.

Dëshmitari/ I dëmtuari N.T. në seancën e shqyrtimit gjyqësor deklaroi se e me tani të akuzuarin A.P., janë fqinjë, shtëpiat i kanë në distancë të afërt prej njëra- tjetrës dhe deri në ditën kritike cdoherë kanë pasur raporte të mira. Sa I përket ngjarjes në atë ditë, dëshmitari theksoi se ka qenë në një fshat afër O.2, së bashku me qenin e tij, të cilin e ka pasur të lidhur me zingjir dhe në kthim nga ai fshat duke kaluar afër shtëpisë së fqit të tij, tani të akuzuarit A.P., nga dyert e oborrit kanë dalur dy apo tre qenë të zgjidhur të cilët kanë filluar të perleshën me qenin e tani të dëmtuarit. Më tutje ka shtuar se ai ishte munduar t'i ndaj qentë, mirëpo pas disa sekondave ka dalur tani i akuzuari A. nga shtëpia me një shkop në duar dhe me të ka filluar të godas së pari qenin e dëshmitarit dhe pastaj qentë e tij dhe në mes tani të akuzuarit A. dhe dëshmitarit ka filluar fjalosja në lidhje me qentë dhe pastaj tani i akuzuari A. kishte hyrë në oborrin e shtëpisë tij dhe nga aty ka dalur para derës së oborrit të shtëpisë, me pushkë të gjuetisë në dorë, ku ka qëndruar rreth 2 sekonda, dhe distanca ndërmjet të dëmtuarit/dëshmitarit dhe tani të akuzuarit ka qenë 20-30 metra, ndërsa që më vonë gjatë deklaratimit ka pohuar se tani i akuzuari A. para deriës së shtëpisë ka qëndruar me armë 10 sekonda, dhe nuk i kujtohet nëse tani i akuzuari e ka kërcënuar apo jo sepse nuk e dinë së çfarë ka folur, ndërsa dëshmitari i kishte thënë "lirisht më gjuaj" dhe pastaj kishte shkuar në shtëpi, ndërsa që pas ballafaqimit me deklaratën e dhënë në Polici me dt. 29.04.2015, ku kishte deklaruar se distance ndërmjet tij dhe të akuzuarit A. ka qenë në largësi prej 15 metrave, është përgjigjur se ka mundur të jetë 15 deri në 20 metra, më së shumti 30 metra. po ashtu ka shtuar se në të njëjtën ditë 15 min pas ngjarjes kishte shkuar në stacionin policor për të dhënë deklaratë lidhur me rastin dhe se nuk ka qenë nën ndikimin e alkoolit, duke shtuar se po të kishte qenë nën ndikim të alkoolit policia do t'a ftonte stafin mjekësor për të bërë verifikimin e gjendjes së tij. Më tutje ka shtuar se me të akuzuarin A., tani i kanë raportet normale sepse janë fqinj dhe se nuk paraqet kërkesë pasurore-juridike.

Nga lista e armëve të konfiskuara e datë 29.04.2015, formularin e konfiskimit të datë 29.04.2015, vërtetimin mbi bastisjen e shtëpisë të datë 29.04.2015, vërtetohet se nga i akuzuari A.P. është sekuestruar arma e tipit “Bokerie” me nr. serik 171442 e kalibrit 12mm, dhe dy fishekë.

Nga fotodokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës shihen të fotografat, në të cilat është e paraqitur arma e fotografuar në pozicione të ndryshme, e gjendur në dollap, pastaj në afërsi është e fotografuar tyta e armës e cila duket së është e zbrazur dhe dy fishekë.

Nga raporti i zyrtarit policor me numër të rastit 2015-AJ-0134, i datës 29.04.2015 konstatohet se në datë të njëjtë rreth orës 16:00 në stacionin policor kishte shkuar tani i dëmtuari/dëshmitari N.T. i cili ka qenë shumë agresiv, në ato momente ka goditur dyert dhe e ka paraqitur rastin e përleshjes me tani të akuzuarin A., ku pasi që i dëmtuari kishte paraqitur ankesën e tij, zyrtarja policore K.H. kishte konstatuar se ankuesi tani i dëmtuari N. kundërmonte erë alkooli dhe se i njëjti kishte pranuar faktin se kishte përdorur narkotikë.

I akuzuari A.P. në mbrojtjen e paraqitur në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë duke e ushqyer bashkëshortën e tij e cila është me aftësi të kufizuara dhe me të njëjtën ka qëndruar brenda në shtëpi dhe pas përfundimit të ushqyerjes, të njëjtën e ka vendosur pranë dritarës dhe ka dalur jashtë në kopsht për të punuar, më pas ka dëgjuar një britmë dhe me vrap ka hyrë në shtëpinë e tij, në duar ka pasur shatin me të cilin ka qenë duke punuar, kur kishte hyrë brenda bashkëshortja e tij i kishte treguar që qenin e tyre po e sulmon qeni i N.T. ku më pas tani i akuzuari nga dritarja kishte vërejtuar përleshjen e qenve si dhe prezencën e tani të dëmtuarit N., dhe kishte dalur jashtë me vrap, ku tani të dëmtuarit i’u kishte drejtuar me fjalët “Pse nuk po e largon qenin , se po don me ma myt qenin tem...” kape qenin dhe largohu...edhe njëherë me ma pru qenin këtu unë ka me të lajmru në polici”, pas kësaj e ka parë tani të dëmtuarin/dëshmitarin N. që së bashku me qenin e tij janë larguar dhe pas 15 minutave kishte ardhur policia, të cilët kishin pyetur lidhur me problemin me N.T. dhe të njëjtin e kishin marrur në Stacion Policor për të dhënë deklaratë, dhe më pas ishte kthyer në shtëpi, ku pas 30 minutave kanë ardhur prap policë të tjerë të cilët i kishin kërkuar pushkën, të cilën u’a kishte dorëzuar menjëherë, po ashtu edhe dy fishekë të cilët ky vet i kishte gjetur pas një kërkimi më të thellë pasi që i kishte fshehur ndër shtat që fëmijët e motrës së tij, të mos kenë qasje në ta. Më tutje ka shtuar, se pushkën e ka që nga viti 1999, e ka mbajtur në dollap dhe ka poseduar leje pasi që ka qenë gjuetar dhe se atë pushkë mirëpo lejen për të njëjtën nuk e kishte vazhduar. Sa i përket raporteve me të dëmtuarin/dëshmitarin N.T., deklaroi se e njeh që 13-14 vite si një njeri që ka qenë nën ndikimin e alkoolit dhe drogës, mirëpo me familjën e tij ka pasur raporte të mira, madje i’u ka ndihmuar për të pastruar oxhakun, dhe sa i përket faktit se tani i dëmtuari/dëshmitar kishte qenë në dijeni që i njëjti posedon pushkë të gjuetisë, i akuzuari deklaroi se këtë fakt e kanë të njohur shumë persona të lagjes pasi që e kishin parë duke dalur në gjueti. Lidhur me vlefshmërinë e lejes së armës, deklaroi se prej momentit që i ka skaduar vlefshmëria e lejes, ai asnjëherë nuk ka dalur me pushkë, dhe marrë për bazë faktin se i është sëmurë bashkëshortja, i njëjti ka hequr dorë nga gjuetia.

Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, në të cilin u administruan të gjitha provat materiale, të cilat i vlerësoi një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën dhe erdhi në përfundim se nuk është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës, pasi që në këtë çështje penale nuk është kontestuese se në ditën kritike, ka pasur një moment tensionimi në mes tani të akuzuarit A.P.dhe N.T., e ardhur si pasojë e faktit të përleshjes së qeve të të njëjtteve, mirëpo kontestuese ka qenë fakti se në momentin kur ka dalur tani i akuzuari A. nga shtëpia, a ka qenë duke mbajtur arëm në duar, gjegjësisht marr pushkën e gjuetisë model turk e kalibrit 12 mm me numër serik 171442, dhe nga provat e administruar nuk është vërtetuar një fakt i tillë, duke qenë se dëshmia e të dëmtaurit N., jo vetëm është kundërthënëse në disa drejtimë, siq është rasti me distancën e tij me tani të akuzarin A.P., ashtu që njëherë thotë se ka qenë 20-30 metra ndërsa pas ballafaqimit thekson se ka mundur të jetë 15- 20 deri në 30 metra, pastaj nëse kanë qenë të pranishmë edhe persona tjerë në at vend në momentin kritik, ashtu që fillimisht në dëshminë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se nuk kanë qenë të pranishmë persona, ndërsa që pasë ballafaqimit ka theksuar se të njëjtit kanë mundur me qenë të pranishëm, mirëpo përveq të qenit kontradiktor, dëshmia e të njëjtit çënohet thelbësisht edhe nga gjendja e të njëjtit në momentin e dhënies së deklaratës në polici me dt.29.04.2015, që siq vërtetohet nga raporti i zyrtares policore K.H. i dt.29.04.2015, tani dëmtuari ka qenë i ndikuar nga alkooli, cka sigurisht nuk i ka mundësuar një përkrahim të sakt dhe të plotë të dinamikës së ngjarjes në momentin kritik, e që kjo ka bërë që edhe mjetin në duart e tani të akuzuarit A. ta shohë ndryshe nga siq ka qenë ai, e që sipas vetë të akuzuarit, ai në momentin kritik ka pasur në dorë një shati, pohim ky të cilit gjykata ja ka fal besimin pasi që i njëjti ka qenë koheren në pohimet e tij, sa i përket zhvillimit të ngjarjes në ditën kritike, e po ashtu edhe vetë i dëmtuar nuk ka qenë i sigurt nëse tani i akuzuari A.P.i ka thënë ndonjë fjalë kërcënuese.

Me dispoziten e nenit 375 par.2 I KPRK-së janë paraparë elementet thelbësore të figurës së kësaj veprë penale ashtu që kjo vepër penale mund të kryhet nga secili person i cili ka për qëllim frikësimin apo kërcënimin e personave duke përdorur armën. Element crucial i ekzistimit të kësaj veprë penale është përdorimi i armës. Përdorimi konsiderohet se është realizuar që nga momenti kur personi e ekspozon armën me qëllim frikësimi ose ia drejton armën, apo e perdorë të njëjtën në atë kuptim që shtie me të apo e drejton në drejtim të personave. Nga gjendja faktike e vërtetuar rezulton se me asnjë provë nuk është vërtetuar fakti se tani i akuzuari A. e ka përdorur armën, dhe rrjedhimisht me këtë është e kuptueshme se nuk janë vërtetuar as elementet tjera të kësaj veprë penale që është dashja dhe elementi i kërcënimit të personit tjetër.

Sa i përket çështjes së konfiskimit të armës, gjykata vendosi që armën e të akuzuarit të mos e konfiskoje, pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se e njëjta është përdorur dhe ka qenë në posedim, më gjegjësisht në duar të të akuzuarit në momentin kritik dhe rrjedhimisht me këtë nuk ekziston baza që e njëjta të konfiskohet sepse arma ka pas leje, mirëpo që të njëjtës i ka skaduar vlefshmëria që nga viti 2010.

Në bazë të nenit 454 par 1 të KPPRK-së është vendosur që shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore.

Nga sa u tha më lart është vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.279/15, të dt: 28.09.2018**

**Bashkëpunëtori profesional,
Driton Berisha**

**Kryetarja e trupit gjykues - gjyqtarja,
Shadije Gërguri**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.